



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

**Z.Anr.261/2017**

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Ymer Hoxha dhe Adnan Konushevci anëtar, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Arjeta Sylja, duke vendosur përkitazi me ankesën e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), dega në Prizren, paraqitur kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dega në Prizren, për shkak të Thyerjes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatet, për Zgjedhjet Lokale 2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 22.10.2017, mori këtë:

### **V E N D I M**

**HUDHET** si e pa rregullt ankesa e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), dega në Prizren, me shenjen ZL.Anr.261/2017 e datës 19.10.2017, e parashtruar kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dega në Prizren.

### **A r s y e t i m**

Me datën 19.10.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Prizren, me të cilën ka pretenduar se kandidati për anëtar të Kuvendit Komunal të Prizrenit, Sefer Saramati, ka vendosur pllakat reklamuese në zonën e mbrojtur të Qendrës Historike, si dhe në afërsi të institucionit Publik përkatësisht Komunës së Prizrenit që është në kundërshtim me Rregulloren, Udhëzimet dhe Ligjin për Qendren Historike të Prizrenit.

Në mbështetje të pretendimeve ankimore ka bashkangjitur dy fotografi në lidhje me rastin në fjalë.

Subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje në përgjigjen në ankesë të datës 20.10.2017, ka theksuar se ankesa është e pabazuar për arsye se data e verifikimit të këtij posterit nuk është cekur në ankesë gjë që e bënë edhe të pa lejuar paraqitjen e kësaj ankesë dhe si e tillë ankesa është e pa lejuar.

Më tej LVV, ka theksuar se shtëpia ku është vendosur posterit ka pëlqim nga pronari i asaj shtëpie.

Përgjigjes në ankesë i ka bashkangjitur Pëlqimin e datës 12.10.2017 për lejimin e pllakatës.

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të lejueshmërisë së ankesës gjeti se:

**Ankesa është e pa rregullt**

PZAP-i, nga shkresat e lëndës vlerësoj se ankesa e parashtruar nga ana e subjektit politik PDK është e parregullt, sepse nuk është e nënshkruar nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës dhe si tillë ankesa nuk i plotëson kërkesat Rregullës Nr.02/2015 të nenit 5.6 ku përcaktohet se: Ankesat duhet të dorëzohen me shkrim dhe duhet të jenë të nënshkruara nga ankuesi apo në emër të tij nga i autorizuari.

Prandaj PZAP-i, nuk u lëshua fare në meritat e ankesës, ngase nuk janë plotësuar kushtet e kërkuara nga dispozita e lartëtheksuara.

Nga arsyet e sipërsënuar e në mbeshetje të nenit 6.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it dhe në kuptim të dispozitës së nenit 118.1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**  
Anr.261/2017 më datën 20.10.2017.

**Kryesuesi i Panelit**  
Gyltene Syljmani



**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.